



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izhorni Panel za žalbe i Predstavke

Anr.656/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Adnan Konushevi, kryesues, Afijete Sada - Gllgjani dhe Kimete Kicaj anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesat e parashtruara nga Birn dhe Internews Kosova I/KS, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), për thyerjen e heshtjes zgjedhore, për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës të datës 17 tetor 2021, në seancën e panelit të mbajtur më datë 18.10.2021, mori këtë:

V E N D I M

Hudhen të pa parregullta ankesat Anr.656/2021, dhe Anr.657/2021 të datës 18.10.2021, të paraqitura nga Birn dhe Internews Kosova I/KS, kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës për thyerjen e heshtjes zgjedhore, në Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës të datës 17 tetor 2021.

A r s y e t i m

Më datën 18.10.2021 PZAP-i ka pranuar ankesat Anr.656/2021, dhe Anr.657/2021 të datës 18.10.2021, të ushtruara nga Birn dhe Internews Kosova I/KS, me të cilën pretendon se gjatë monitorimit të procesit të zgjedhjeve, në ditën e zgjedhjeve në qytetin e Istogut, më saktësisht në fshatin Vrellë kanë vërejtur poster të kandidatëve të PDK-së, përballë qendrës së votimit 0606C. Gjithashtu Gent Gjini kandidat për asambleist në komunën e Prizrenit, ditën e zgjedhjeve më datë 17 tetor 2021 përmes rrjetit social Facebook në mënyrë të vazhdueshme ka postuar fotografi me anë të cilave ka kërkuar nga qytetarët që ta votojnë.

Paneli, pasi që vlerësoj lejueshmërinë e ankesave të lartpërmendura, gjeti se ato janë të **parregullta**, për këto arsye:

Paneli, pasi ka vlerësuar pretendimet në ankesat Anr.656/2021, dhe Anr.657/2021 të datës 18.10.2021, të cilat për nga përmbajtja janë të njëjta, për nga natyra e shkeljes së pretenduar janë të njëjta, paraqitës i ankesave është Birn dhe Internews Kosova I/KS dhe po ashtu të njëjtat janë paraqitur kundër subjektit të njëjtë politik Partia Demokratike e Kosovës, prandaj Paneli, bazuar në nenin 8 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave Nr.02/2015, të PZAP-it, në të cilën përcaktohet se: *“Me qëllim të lehtësimit të shqyrtimit të ankesave kryesuesi i panelit vendimmarrës mund të vendos ta bëjë bashkimin e ankesave që përmbajnë në vete çështje të ngjashme dhe se ato ankesa të trajtohen me një vendim”*, bëri bashkimin e ankesave dhe për të njëjtat vendosi me një vendim, si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli, nga shkresat e lëndës vlerësoj se ankesat e paraqitura, nga Birn dhe Internews Kosova I/KS, me seli në Prishtinë, kundër subjektit politik PDK, janë të parregullta, pasi që ankesat e

paraqitura në PZAP, nuk janë të nënshkruara nga ankuesi, andaj ankesat e paraqitura nuk i plotësojnë kushtet ashtu siç parashihet me nenin 5.6 të Rregullës Nr.02/2015 për Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, ku theksohet se: *ankesat duhet të dorëzohen me shkrim dhe të jenë të nënshkruara nga ankuesi apo në emër të tij nga i autorizuari. Në rastet kur ankuesi/ja është parti politike, koalicion, iniciativë qytetare apo nga çfarëdo personi tjetër juridik, ankesa duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi i autorizuar i ati personi juridik siç është përcaktuar në rastet ku kjo është e mundshme në çfarëdo dispozite ligjore ne fuqi.*

Prandaj Paneli, me rastin e shqyrtimit të lejueshmërisë së ankesave, gjeti se të njëjtat janë të parregullta sepse nuk janë nënshkruar nga ankuesi, dhe se të njëjtat nuk i plotësojnë kriteret sipas nenit 5.6 të Rregullës Nr.02/2015 për Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, andaj nuk u lëshua fare në meritat e ankesës, ngase nuk janë plotësuar kushtet e kërkuara nga dispozita e lartcekur.

Nga arsyet e lartcekura e në mbështetje të nenit 5.6 të Rregullës Nr.02/2015 për Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, dhe në kuptim të dispozitës së nenit 118.1 të LZP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Anr. 656/2021 më datën 18.10.2021

Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.

